

R E Z O L U T Ë

PËR GJENDJEN NË KOSOVË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur në seancë të posaçme më 26 dhjetor 1998, pasi dëgjoji parashtrimin e Qeverisë për gjendjen aktuale në Kosovë; vëren se:

Intensifikimi i dhunës dhe i operacioneve në shkallë të gjerë ka rënduar edhe më tej krizën humanitare dhe po shton ndjeshëm numrin e shqiptarëve që braktisin vatrat e tyre në mesin e një dimri të ashpër.

Autoritetet e Beogradit vijojnë zbatimin e metodave të hapura e brutale të spastrimit etnik, duke konfirmuar politikën e mohimit të plotë e sistematik të të drejtave kombëtare themelore e njerëzore të shqiptarëve të Kosovës.

Politika provokative e Beogradit në kufirin me Republikën e Shqipërisë synon zgjerimin e konfliktit në të gjitha hap shqiptare.

Qeveria Jugosllave në mënyrë sistematike shkel rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-s dhe marrëveshjet e nënshkruara me OSBE-n, NATO-n dhe përfaqësuesit amerikanë.

Marrëveshja e verifikimit po zvarritet për shkak të qëndrimit të palës serbe me rrjedhim mungesën e rezolutave të dukshme për gjetjen e një zgjidhjeje politike të krizës.

Duke patur parasysh sa më sipër, mbështetur edhe në rezolutat e mëparshme, Kuvendi i Republikës Shqipërisë:

- Kërkon një angazhim më të madh dhe me efektiv të bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, OSBE-s NATO-s, BE-se dhe organizmave të tjera ndërkombëtare. Në rrethanat e krijuara është domosdoshmëri ndërhyrja e forcave të NATO-s në Kosovë për përshpejtimin e zgjidhjes së konfliktit, shmangien e katastrofës humanitare dhe arritjen e marrëveshjes politike;

- Kërkon si gjithnjë mbështetjen e fuqishme nga ana e Qeverisë dhe shtetit shqiptar për vëllezërit kosovare, në përhallimin e situatave të jashtëzakonshme në të cilat ndodhen dhe në përpjekjet e tyre për të vendosur vetë për të ardhmen e Kosovës;

- U bën thirrje forcave politike në Shqipëri dhe në Kosovë që të mbajnë qëndrime unike në përballimin dhe zgjidhjen e krizës në Kosovë;

- Nënvizon edhe një herë rëndësi që ka faktori ndërkombëtar në zgjidhjen e konfliktit dhe angazhimi i tij i drejtpërdrejtë në organizimin e një konference ndërkombëtare për të përcaktuar të ardhmen e Kosovës.

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që kjo Rezolute ti përcillet Kongresit të SHBA-s parlamenteve të vendeve Europiane, si dhe institucioneve dhe organizatave të tjera euroatlantike.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më 28.12.1998.